



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. dhe 1.5., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, më datën 19.07.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Dep.	06/02	Nr. Prot.	1447/23
Dep.		Nr. Prot.	
Nr. Faj.	02	Data	19.07.2023
Nr. Ser.		Data	
Nr. Pige.		Data	

Mbyllet rasti me nr. APK-DPKI-06-016/23, për zyrtarin e lartë Hajrullah Koliqi, Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të kërkesës nga jashtë (raportues i rastit), ka filluar procedurën e hetimit administrativ për shqyrtimin e konfliktit të interesit, lidhur me pretendimet si në vijim:

“Hajrullah Koliqi, është Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Anëtar i Këshillit Drejtues në Institutin Pedagogjik të Kosovës.

Është familjar (baba) i profesoreshës së Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” znj. R.K dhe znj. D. K”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë njoftuese për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pastaj është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt interesi.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se; Hajrullah Koliqi, Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” ishte edhe Kryetar i Këshillit Shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës.

Ushtrimi i funksionit Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe njëkohësisht Kryetar i Këshillit Shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës, nuk është e ndaluar me Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit sepse ky Ligj nuk ka përcaktuar dispozita kufizuese lidhur me këtë situatë.


Gjatë zhvillimit të procedurës, me vetë iniciativë dhe për arsye personale, zyrtari i lartë Hajrullah Koliqi, ka dhënë dorëheqje nga detyra e Kryetarit dhe Anëtarit të Këshillit Shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës, shkresa nr. (06/02-1283-1).

Sa i përket pretendimit se; "Hajrullah Koliqi, Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" është familjar (baba) i profesoreshës znj. R.K dhe znj. D. K", duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të interesit situata e tillë nuk paraqet konflikt interesi.

Andaj, nga sa u tha më lartë, për pretendimet e ngritura nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit
